



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot.

Data: 20.2.2025

Nr: 119

Ora: 13:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË "KESH SH.A", PËR  
PERIUdhËN 09 SHKURT-15 SHKURT 2025**

Sot, më datë 20.2.2025, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me

**SUBJEKT:** "KESH" sh.a

**OBJEKT:** Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të "KESH" sh.a, për periudhën 09 shkurt-15 shkurt 2025.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 19 pika 1, shkronja "n", 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator "Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve", i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**KONSTATOJ:**

Gjatë periudhës 09 shkurt-15 shkurt 2025, "KESH" sh.a ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon:

- "Rikonstruksioni i rrugës Qafë-Qelë-Koman", raportuar në datë 10.02.2025 për t'u zhvilluar në datë 10.02.2025

Nëpërmjet postës elektronike, administrata e KQZ-së i ka kërkuar "KESH" sh.a një informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes.

Data: 20.2.2025 Nr: 119  
Ora: 13:00



"Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të "KESH" sh.a, për periudhën 09 shkurt-15 shkurt 2025"

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të “KESH” sh.a ka dërguar pretendimet, duke sqaruar si vijon: *“Ju bëj se nga ana ime ka qenë një gabim teknik sepse ky aktivitet nuk ka qenë i “KESH” sh.a”, por i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”*.

Për sa më sipër, pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, në referim të pikës 3, të nenit 5, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, i ndryshuar, ku parashikohet se raportimi në NRI bëhet nga për veprimtari, të cilat organizohen ose bashkëorganizohen, nga institucioni publik raportues. Nuk raportohen veprimtari ku institucioni publik, apo përfaqësues të tij janë ftuar për të marrë pjesë. Në këto kushte veprimtaria nuk mbart detyrim për raportim dhe nuk jemi para kundërvajtjes administrative.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

### **V E N D O S:**

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj “KESH” sh.a.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**